

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, __/11/2017

Procesverbal

Sot në datë 17.11.2017 u mbajt dëgjese publike në ambjentet e Njesisë Administrative nr.5 me tematike “Buxheti për vitin 2018 për Njesisë Administrative nr.5, Bashkia Tiranë”. Në këtë takim ishin të pranishëm : Administratori i Njesisë Administrative nr.5 **znj.Violeta Kila**, i pranishëm ishte dhe **z.Erind Bejko**, Drejtor në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi, Koordinimi i Njesisë Administrative dhe Emergjencat Civile dhe gjithashtu ishte **z.Pandeli Majko**, Deputet i Njesisë nr.5, ndërlidhësit për komunitetin, punonjës të ujësjellësit si dhe qytetarë nga kjo njësi.

Programi i këtij takimi:

Znj Violeta Kila, Administrator i Njesisë Administrative nr.5, pasi falenderoi pjesëmarrësit përmëndi edhe investimet që aktualisht po bëhen dhe janë bërë në këtë njësi:

- 1.Rikonstruksioni i Bllokut ne Rrugën “Grigor Heba”.
- 2.Rikonstruksion i Bllokut “Pallatet e Aviacionit te Ri” Rruga “Pjeter Bogdani”.
- 3.Ndertimi i Rruges se “Kosovareve”.
- 4.Rikonstruksion i Infrastruktures Rrugore te Bllokut te kufizuar nga “Mentor Xhemali”, “Dhimiter Pashko”, “Hajdar Tafa”, “Hasan Vogli”, “Gjin Gjergji”.
- 5.Rikonstruksion i Trotuareve te Rruges “Deshmoret e 4 Shkurtit”, (Ish “Sami Frasheri, nga Sheshi “Willson”, deri tek “Kristo Luarasi” dhe Trotuaret ne Rrugen “Perlat Rexhepi”.
- 6.Rikonstruksioni i Sheshit brenda Pallatit “Me Shigjeta”.
- 7.Rruga “Hysen Zaloshnja”.
- 8.Rikonstruksioni i Bllokut “Leka i Madh”, “Hmdi Pepa”, “ David Selencia”, “Kujtim Spahivogli”, ne fazen permbyllese.
- 9.Lulishtja e re ne Rrugen “Sulejman Delvina”P.(6-8).
- 10.Rikonstruksion i Lulishtes ne Rrugen “Medar Shtylla”.
- 11.Rikonstruksion i Ures mbi Lane-Blloku “Irfan Tomini”.
- 12.Rikonstruksion i Lulishtes –Aneksi i Stadiumit “Selman Stermasi”.
- 13.Rikonstruksion i Tregut ne Rrugen “Komuna e Parisit”,
- 14.Rikonstruksion i Shkolles “Vasil Shanto”.
- 15.Rikonstruksion i Cerdhes ne Rrugen “Ilo Mitke Qafezezi”.
- 16.Perfitimi nga Fondi i Komuniteteve 50 me 50 nga ana e Pallatit “HAWAI” Rruga “Tish Daija”,sipas projektit.

Falenderimi gjithashtu shkon për Ndërmarrjen e Ujësjellës - Kanalizimeve për punën e bërë .

Z.Erind Bejko, Drejtor në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi, Koordinimi i Njësive Administrative dhe Emergjencat Civile.

Bashkë me falenderimet për pjesëmarrjen Z. Bejko përmëndi investimet që janë bërë nga Bashkia Tirane. Parashikimet për vitin e ardhshëm do ruajnë të njëjtën vlerë si viti që lam pas.

Nga z.Bejko u përmëndën këto investime për vitin 2018:

- 1.Rikonstruksion I Rruges “Dhimiter Shuteriqi”
- 2.Rikonstruksion i Rruges “Ibrahim Kodra”
- 3.Rikualifikim Rrugeve “Liman Kaba”, “Robert Shvarc”, “Tish Daija”. Etj....

Diskutimet vazhduan në formë bashkëbisedimi midis qytetarëve si përfaqësuesve të Bashkisë Tiranë

Qytetari I –Rehabilitimi i Rruges “Sami Frasheri” Pallati 22/1, dhe Pallati 1 “Sulejman Delvina”.

Qytetari II –Ne Bllokun “Vasil Shanto”, kemi te nevojshme vendosjen e nje kendi lojerash,stola si dhe ka probleme me ujin.

Qytetari III –Ne Rrugen “Andon.Zako.Cajupi”,kuadrati te Pallatet “ Hoxholli”, ka nevoje per asfaltim.

Qytetari IV –Blloku i Vilave “Selite”, rruge te paasfaltuara,probleme me ujerat e zeza,(30 familje kane probleme pasi pusetat nuk jane te vendosura ne pozicionin e duhur)

Qytetari V –Ne bllokun Nr30 ndodhet nje pallat i vjeter 2- katesh i cili i ka bodrumet te mbushura me uje.Nese eshte e mundur te behet nje devijim i kanalizimeve.Gjithashtu kemi te nevojshme vendosjen e matesave te ujit ne pallatet e vjetra si dhe stola per banoret.

Qytetari VI –Kerkojme ndertimin e nje Ure lidhese(Pasarele) midis Pallateve te Rruges “Irfan Tomini” dhe Njesise Nr.7(premtim i Kryetarit te Bashkise,Z.Erjon Veliaj).

Qytetari VII-Kekojme zgjerimin e rruges te Shkolla “At Zef Pllumi”

Qytetari VIII-Ndricim te Rruges “Ibrahim Kodra”

Qytetari VIV-Ndertimi i nje Shkolle 9-vjecare si dhe Ndertimi i nje Shkolle te dyte “Petro Nini Luarasi”, per shkak te numrit te madh te kerkesave qe ka per kete shkolle.

Z.Erind Bejko: Ne Muajin Mars fillon ndertimi i Shkolles se pare.

Qytetari X-Ne Rrugen “Vaso Pasha”,pas Fakultetit Juridik kemi probleme te perzierjes se ujerave te zeza me ujerat e bardha(Rikualifikim Urban).

Z.Erind Bejko:Do verifikohet dhe nese eshte e nevojshme do te nderhyet sipas situates.

Qytetari XI-Ne zonen e Selites mbi Unaze eshte e nevojshme vendosja e ndricimeve dhe kanalizimeve(Investim ne bllok,prioriteti i pare).

Z.Erind Bejko:Do ta rishikojme ne Buxhetin e vitit 2018

Qytetari XII-Ne Blllokun “Irfan Tomini”,pallati ne krah te Shkolles “26 Nentori”ka vetem gjysem ore uje ne dite.Kerkojme te rregullohen lidhjet e ujesjellesit.

Mbledhja u mbyll me një falenderim për të gjithë pjesëmarrësit!